



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
IDENTITEK SHA

**RREGULLAT E BRENDSHME PËR SINJALIZIMIN, HETIMIN ADMINISTRATIV TË
SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN NGA HAKMARRJA NË IDENTITEK SHA**

**KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Baza ligjore**

Kjo rregullore bazohet në Ligjin Nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, në Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, Ligjin nr. 124/2024, datë 19.12.2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe në aktet nënligjore të miratuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e në vijim “**ILDKPKI**”).

**Neni 2
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për paraqitjen, pranimin, regjistrimin, shqyrtimin dhe ndjekjen e sinjalizimeve pranë IdentiTek, funksionimin e Njesisë Përgjegjëse, ruajtjen e konfidencialitetit, si dhe mbrojtjen e sinjalizuesit nga veprimet hakmarrëse, në zbatim të Ligjit Nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

**Neni 3
Përkufizime**

1. Termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Sinjalizues” është çdo person fizik që, në një Kontekst Pune, Sinjalizon ose bën publik Informacion mbi një Shkelje të mundshme.
- b) “Sinjalizim” është raportimi apo Sinjalizimi i informacionit verbal ose me shkrim nga Sinjalizuesi tek Njësia Përgjegjëse, ose tek ILDKPKI për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të kryera në një mjedis pune në një Autoritet Publik, nëpërmjet kanaleve të Brendshme, të Jashtme ose nëpërmjet Publikimit, në përputhje me ligjin për Sinjalizuesit:
 - “Sinjalizim Anonim” është Sinjalizimi i kryer nga një Sinjalizues, identiteti i të cilit nuk është i njohur për Autoritetin Kompetent ose për Njësinë Përgjegjëse në momentin e paraqitjes së Sinjalizimit, ose kur vetë Sinjalizuesi ka kërkuar të mbetet Anonim gjatë këtij procesi. Sinjalizimet Anonime trajtohen nga Njësia Përgjegjëse ose nga ILDKPKI në të njëjtën mënyrë si çdo Sinjalizim tjetër, pa u vendosur kushte shtesë

për pranimin, shqyrtimin dhe verifikimin e tyre. Sinjalizimi Anonim mund të paraqitet përmes mekanizmit të Brendshëm, të Jashtëm ose nëpërmjet Publikimit. Në rastet kur identiteti i Sinjalizuesit identifikohet, ai mund të zbulohet vetëm me pëlqimin e tij të shprehur ose me kërkesë të organeve procedurale kompetente.

- “Sinjalizim i Brendshëm” është Sinjalizimi i kryer nga Sinjalizuesi brenda Njesisë Përgjegjëse të IdentiTek.
 - “Sinjalizim i Jashtëm” është Sinjalizimi i kryer nga Sinjalizuesi pranë Autoritetit Kompetent. Sinjalizimi i Jashtëm mund të paraqitet në çdo fazë, pa qenë i kushtëzuar nga kryerja paraprake e Sinjalizimit të Brendshëm. Ai mund të bëhet drejtpërdrejt pranë Autoritetit Kompetent, kur Sinjalizuesi vlerëson se shkelja nuk mund të trajtohet në mënyrë efektive brenda Autoritetit Publik ku ka sinjalizuar fillimisht, ose kur ekziston rreziku i ndërmarrjes së Veprimeve Hakmarrëse ndaj tij apo personave të lidhur me të. Për më tepër, Sinjalizimi i Jashtëm mund të kryhet edhe kur Sinjalizuesi ka paraqitur më parë Sinjalizimin pranë Njesisë Përgjegjëse dhe nuk është informuar për ecurinë ose trajtimin e tij.
 - “Sinjalizim Publik” është Sinjalizimi, zbulimi ose komunikimi publik i informacionit në lidhje me shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore, nëpërmjet medias së shkruar e audiovizive, medias *online* dhe sociale, takimet publike, njoftimet publike e të gjitha komunikimet verbale, të shkruara dhe të regjistruara. Sinjalizuesi, që bën publikisht një Sinjalizim për një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor përfiton nga Autoriteti Kompetent mbrojtje nëse plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme: (i) personi fillimisht ka bërë më parë Sinjalizim të Brendshëm dhe të Jashtëm ose direkt Sinjalizim të Jashtëm, por nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme si përgjigje ndaj tij; ose (ii) Sinjalizuesi ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se shkelja përbën rrezik të menjëhershëm ose të dukshëm për interesin publik, përfshirë situatat e emergjencës, ose rastet kur ka rrezik të dëmit të pariparueshëm; (iii) apo në rast Sinjalizimi të Jashtëm ekziston mundësi e ulët që shkelja të trajtohet në mënyrë efektive për shkak të rrethanave specifike të çështjes, si rreziku i fshehjes ose shkatërrimit të provave, rreziku i hakmarrjes ndaj Sinjalizuesit, ose rastet e përfshirjes apo bashkëpunimit të Autoritetit Kompetent në shkelje.
- c) “Veprim hakmarrës” është çdo veprim apo mosveprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i ndërmarrë në një Kontekst Pune, që ndodh pasi një person ka Sinjalizuar ose planifikon të sinjalizojë një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor nëpërmjet mekanizmave të Brendshëm, të Jashtëm ose Publik, që shkakton ose mund të shkaktojë dëm për Sinjalizuesin.
- ç) “Kontekst Pune” është çdo marrëdhënie profesionale, aktuale, e mëparshme ose e mundshme, përmes së cilës një person, pavarësisht nga natyra e saj juridike, ka akses në informacione për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, përfshirë marrëdhëniet e punësimit ose të vetëpunësimit, ofrimin e shërbimeve, kontratat e furnizimit, nënkontraktimin, si dhe aktivitetet vullnetare apo praktikat profesionale.
- d) “Informacion për Shkeljet” është çdo lloj informacioni që përmban dyshime të arsyeshme dhe lidhet me shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të kryera ose që ka gjasa të kryhen nga IdentiTek, të cilat janë përfutur në një kontekst pune, përfshirë rastet kur informacioni është marrë nga kontraktorë, nënkontraktorë, furnitorë apo punonjësit e tyre.

- dh) “Masa të Përkohshme” janë masa të marra nga ILDKPKI ose të vendosura nga gjykata, me qëllim garantimin e mbrojtjes së Sinjalizuesit deri në përfundim të procesit administrativ apo gjyqësor përkatës.
- e) “Njësi Përgjegjëse” është organi i posaçëm i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit, shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit dhe ndjekjen e saj sipas përcaktimeve të këtij ligji brenda IdentiTek. Njësia Përgjegjëse për Sinjalizimin, e krijuar me urdhër të Administratorit, përbëhet nga 2 (dy) punonjës të Njesisë së Auditit të Brendshëm të IdentiTek dhe, në ushtrimin e funksioneve të saj, gëzon pavarësi funksionale.
- ë) “Autoritet Kompetent” është ILDKPKI, i caktuar për të pranuar, për të shqyrtuar e për të ndjekur Sinjalizimet e Jashtme, si dhe për të garantuar mbrojtjen nga veprimet hakmarrëse ndaj Sinjalizuesit.
- f) “Autoritet Publik” është shoqëria IdentiTek, e krijuar me Vendimin Nr. 80, datë 14.02.2023 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike”.

Neni 4

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për çdo person që Sinjalizon ose disponon informacion mbi Shkelje të mundshme të legjislacionit në fuqi pranë IdentiTek, përfshirë edhe normat e nxjerra nga organizata ndërkombëtare kur zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Shqipërisë. Fusha e zbatimit përfshin çdo veprim apo mosveprim të kundërligjshëm që cenon interesin publik, integritetin institucional, transparencën, administrimin e fondeve publike, mbrojtjen e të dhënave personale, prokurimin publik, sigurinë e informacionit apo çdo fushë tjetër të parashikuar sipas legjislacionit në fuqi. Kjo rregullore nuk zëvendëson procedurat e zakonshme të ankesave individuale të punës, përveç rasteve kur çështja e paraqitur përbën ose mund të përbëjë shkelje të mundshme ligjore, në kuptim të Ligjit Nr. 96/2025.
2. Sinjalizimi lidhet, ndër të tjera dhe për aq sa është e zbatueshme për veprimtarinë e IdentiTek, me fushat e mëposhtme:
 - a) përdorimi i fondeve të buxhetit të shtetit, të Bashkimit Evropian apo të organizatave ndërkombëtare;
 - b) prokurimi publik;
 - c) shërbimet financiare, produktet e tregjet financiare, parandalimi i pastrimit të parave dhe financimi i terrorizmit;
 - ç) shkeljet që lidhen me rregullat e tregut të brendshëm, përfshirë shkeljet e rregullave të konkurrencës dhe të ndihmës shtetërore, rregullat për tatimin e shoqërive tregtare ose marrëveshjeve që synojnë përfitimin e një avantazhi tatimor, i cili cenon objektin ose qëllimin e legjislacionit përkatës tatimor për shoqëritë tregtare;
 - d) siguria dhe përputhshmëria e produkteve;
 - dh) siguria e transportit;
 - e) mbrojtja e mjedisit;
 - ë) mbrojtja nga rrezatimi dhe siguria bërthamore;
 - f) shëndeti publik;

- g) mbrojtja e konsumatorit;
 - gj) mbrojtja e të dhënave personale, privatësia e siguria e rrjeteve dhe e sistemeve të teknologjisë së informacionit.
3. Kjo rregullore zbatohet për Sinjalizimet e Brendshme, të Jashtme, Anonime dhe Publike, që raportojnë për Shkelje të mundshme të kuadrit ligjor.
 4. Përfshihen nga zbatimi i kësaj rregullore fushat e rregulluara në mënyrë të posaçme dhe që lidhen me: (i) mbrojtjen e informacionit të klasifikuar sipas Ligjit Nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”; (ii) ruajtjen e sekretit profesional të avokatit sipas Ligjit Nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”; (iii) konfidencialitetin e informacionit mjekësor për mbrojtjen e të dhënave personale dhe për kujdesin shëndetësor; (iv) konfidencialitetin e diskutimeve dhe të vendimeve të marra në dhomë këshillimi; (v) rregullat e procedurat që rregullojnë ndjekjen penale.
 5. Parashikimet e kësaj rregulloreje nuk kufizojnë të drejtën e Sinjalizuesit për të paraqitur në çdo kohë kallëzim drejtpërdrejt pranë organeve kompetente për ndjekjen penale.

Neni 5 **Paraqitja e sinjalizimit**

Sinjalizimi mund të paraqitet pranë Njesisë Përgjegjëse me shkrim, nëpërmjet formularit të Sinjalizimit ose çdo forme tjetër të shkruar, nëpërmjet kanalit/adresës elektronike të dedikuar nga IdentiTek, me zarf të mbyllur drejtuar Njesisë Përgjegjëse, verbalisht nëpërmjet takimit fizik, ose në mënyrë anonime. Sinjalizimi verbal dokumentohet me procesverbal, i cili i vihet në dispozicion Sinjalizuesit për verifikim dhe nënshkrim. Sinjalizuesi nuk është i detyruar të provojë plotësisht shkeljen, por duhet të paraqesë, për aq sa është e mundur, faktet, datat ose rrethanat, personat apo strukturat e përfshira dhe çdo dokument mbështetës. Sinjalizimi Anonim mund të realizohet edhe nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit, si dorëzimi i një letre pranë zyrës së Njesisë Përgjegjëse apo ILDKPKI, dërgimi i një email-i nga një adresë e paidentifikuar, ose nëpërmjet mjeteve të tjera të ngjashme që ruajnë anonimitetin. Sinjalizimi quhet i realizuar kur është raportuar te Njësia Përgjegjëse apo Autoriteti Kompetent. Çdo punonjës që vihet në dijeni të një shkelje ligjore ka detyrimin të sinjalizojë.

Neni 6 **Detyrimet e Njesisë Përgjegjëse në IdentiTek**

1. Njësia Përgjegjëse nuk refuzon marrjen dhe regjistrimin fillestar të Sinjalizimit; pas verifikimit paraprak, ajo mund të vendosë mosfillimin e hetimit vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.
2. Në rast se Sinjalizimi lidhet me një anëtar të Njesisë Përgjegjëse ose krijon konflikt interesi për të, ky anëtar nuk merr pjesë në shqyrtimin e Sinjalizimit.
3. Njësia Përgjegjëse ka detyrimin të pranojë, regjistrojë dhe konfirmojë marrjen e Sinjalizimit brenda 7 (shtatë) ditëve (përveç rasteve kur kjo rrezikon anonimitetin). Ajo

duhet të informojë Sinjalizuesin për ecurinë dhe rezultatin, si dhe të garantojë funksionimin e kanaleve të sigurta që mbrojnë konfidencialitetin dhe parandalojnë aksesin e paautorizuar..

4. Njësia duhet të ofrojë informacion të qartë për procedurat dhe mbrojtjen e Sinjalizuesve, si edhe ta informojë automatikisht Sinjalizuesin për veprimet e ndërmarra dhe arsyetimin përkatës.
5. Punonjësi i ngarkuar me trajtimin e Sinjalizimeve ushtron detyrën me pavarësi dhe gëzon mbrojtje ligjore nga çdo Veprim Hakmarrës. Nëse Sinjalizimi merret nga një person i cili nuk është pjesëtar i Njesisë Përgjegjëse apo Autoritetit Kontraktir, ai duhet ta përcjellë menjëherë te Njësia Përgjegjëse ose Autoriteti Kompetent, duke ruajtur konfidencialitetin.
6. Njësia Përgjegjëse nuk jep konfirmime, mohime apo të dhëna mbi ekzistencën e Sinjalizimeve ose mbi identitetin e Sinjalizuesve për qëllime të procedurave disiplinore, administrative apo të marrëdhënieve të punës, përveç rasteve kur një gjë e tillë kërkohet shprehimisht nga organet kompetente sipas ligjit.
7. Njësia Përgjegjëse përgatit raport vjetor dhe e paraqet pranë ILDKPKI jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës.
8. Njësia Përgjegjëse mban regjistrin dhe dosjen e Sinjalizimeve në mënyrë të sigurt, në format fizik ose elektronik, duke kufizuar aksesin vetëm tek personat e autorizuar.

Neni 7

Detyrimi për ruajtjen e identitetit të Sinjalizuesit

1. Njësia Përgjegjëse ka detyrimin të ruajë konfidencialitetin dhe të mbrojë identitetin e Sinjalizuesit, burimin e informacionit, personat e përfshirë në Sinjalizim dhe çdo të dhënë që mund të çojë në identifikimin e tyre.
2. Përpunimi i të dhënave personale në kuadër të zbatimit të kësaj rregullore kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duke mbledhur dhe përpunuar vetëm të dhënat e nevojshme për trajtimin e Sinjalizimit; të dhënat e mbledhura rastësisht, që nuk janë të nevojshme për këtë qëllim, fshihen pa vonesë, ndërsa çdo shkelje e konstatuar e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Identiteti i Sinjalizuesit dhe çdo e dhënë që mund të çojë në identifikimin e tij nuk zbulohen pa pëlqimin e tij të shprehur, përveç rasteve kur zbulimi kërkohet nga organet procedurale kompetente, në përputhje me ligjin.
4. Dokumentacioni origjinal i Sinjalizimit ruhet në mënyrë të sigurt për afatin e parashikuar nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi, me akses të kufizuar vetëm për personat e autorizuar.

Neni 8
Mbrojtja kundër hakmarrjes

1. Sinjalizuesi gëzon mbrojtje kur, në momentin e Sinjalizimit, ka pasur shkaqe të arsyeshme për të besuar se informacioni ishte i vërtetë, se lidhej me një Shkelje të mundshme të kuadrit ligjor dhe se Sinjalizimi është kryer sipas mekanizmave të parashikuar nga ligji dhe kjo rregullore. Mbrojtja zbatohet ndaj çdo veprimi, mase ose vendimi që cenon të drejtat apo interesat e ligjshme të Sinjalizuesit dhe që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me Sinjalizimin. Mbrojtja nga hakmarrja përfshin, por pa u kufizuar në:
 - a) mbrojtje nga të gjitha format:
 - shkarkimi nga puna;
 - pezullimi nga detyra;
 - transferimi brenda shoqërisë, ose ndryshimi i orarit të punës;
 - ulja në detyrë;
 - ulja e pagës dhe shpërblimeve financiare;
 - humbja e statusit profesional, ose e privilegjeve të lidhura me pozicionin;
 - mohimi i mundësisë për ngritje në detyrë;
 - përjashtimi nga programet e trajnimit;
 - vlerësimi negativ në marrëdhënien e punës;
 - intimidimi, ngacmimi, presioni psikologjik apo përjashtimi nga ambienti i punës;
 - diskriminimi ose trajtimi i padrejtë;
 - mosrinovimi i kontratës së përkohshme në një kontratë të përhershme, kur punonjësi kishte pritshmëri të ligjshme për punësim të përhershëm;
 - përfundimi ose mosrinovimi i kontratës së përkohshme;
 - dëmtimi i reputacionit, kryesisht në mediat sociale, ose humbja e të ardhurave apo e mundësive të biznesit;
 - përfshirja në “listë të zezë” nëpërmjet marrëveshjeve formale, ose informale, që pengojnë punësimin në sektorin përkatës në të ardhmen;
 - përfundimi ose anulimi i parakohshëm i kontratës për mallra ose shërbime;
 - anulimi i licencës, ose i lejes së ushtrimit të aktivitetit;
 - referimi i pajustificuar për ekzaminim psikiatrik ose mjekësor;
 - kërcënim, ose përpjekja për të ndërmarrë secilin nga veprimet e mësipërme;
 - izolimi profesional, përjashtimi nga proceset vendimmarrëse apo marginalizimi i heshtur në ambientin e punës.
 - b) mbrojtje të identitetit dhe ruajtje të konfidencialitetit gjatë procesit të Sinjalizimit, përfshirë edhe rastet e Sinjalizimit Anonim;
 - c) ruajtje të konfidencialitetit të burimit të informacionit të sinjalizuar;
 - ç) ndihmë juridike falas, në përputhje me Ligjin Nr. 11/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
2. Çdo Veprim Hakmarrës ndaj Sinjalizuesit është i pavlefshëm. Të drejtat e Sinjalizuesit kanë epërsi ndaj çdo marrëveshjeje për konfidencialitetin.
3. Sinjalizuesi paraqet kërkesë për mbrojtje pranë Autoritetit Kompetent, nëse vlerëson se është bërë objekt i Veprimeve Hakmarrëse për shkak të Sinjalizimit.

4. Sinjalizuesi mund të kërkojë zhvendosjen në një pozicion tjetër për shkak të krijimit të një mjedisi pune armiqësor ose të papërshtatshëm, si pasojë e Sinjalizimit.
5. IdentiTek merr masat e nevojshme për realizimin e kësaj zhvendosjeje, për aq sa është e mundur nga pikëpamja organizative dhe operacionale.
6. Në rast të mosmarrjes së masave brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh kalendarike nga data e marrjes së kërkesës, Sinjalizuesi ose çdo person i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.
7. Sinjalizimi kryhet me përgjegjshmëri, pa shpifur, mashtruar apo dhënë me vetëdije informacion të rremë në dëm të personave të përfshirë në Sinjalizim. Në rast se, gjatë një shqyrtimit gjyqësor, provohet se Sinjalizuesi, me dijeni të plotë, ka kryer një Sinjalizim të rremë, zbatohen pasojat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, përfshirë të drejtën e personave të dëmtuar për të kërkuar kompensimin e dëmit.
8. Në çdo procedurë administrative ose gjyqësore që lidhet me një Veprim Hakmarrës, pasi Sinjalizuesi ose personi tjetër i mbrojtur provon se ka kryer një Sinjalizim dhe ka pësuar dëm, prezumohet se dëmi është rezultat i hakmarrjes. IdentiTek mban barrën për të provuar se masa ose veprimi është ndërmarrë për arsye të ligjshme dhe të pavarura nga Sinjalizimi.

Neni 9 Autoriteti Kompetent

1. ILDKPKI:

- a) pranon, regjistron dhe konfirmon marrjen e sinjalizimit, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e paraqitjes, përveç rasteve kur Sinjalizuesi ka kërkuar shprehimisht të mos merret konfirmim ose kur konfirmimi rrezikon mbrojtjen e identitetit të tij;
- b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga konfirmimi i marrjes së Sinjalizimit harton një raport, ku vlerëson nëse të drejtat e Sinjalizuesit janë shkelur ose janë vënë në rrezik;
- c) vlerëson nevojën për marrjen e Masave të Përkohshme për mbrojtjen e Sinjalizuesit nëse krijohet bindja se ai mund të jetë objekt i Veprimeve Hakmarrëse;
- ç) përcjell raportin për shkeljen e mundshme të Njësia Përgjegjëse, ndjek ecurinë e hetimit dhe informon Sinjalizuesin për rezultatet;
- d) trajton kërkesat për mbrojtje nga Veprime Hakmarrëse, të paraqitura nga Sinjalizuesi;
- dh) heton çdo Veprim Hakmarrës ndaj Sinjalizuesit;
- e) garanton ruajtjen e identitetit të Sinjalizuesit dhe të dhënave të marra nga Sinjalizimi ndaj çdo zbulimi të paautorizuar;
- ë) harton një dokument të plotë dhe lehtësisht të aksesueshëm, që përshkruan procedurat për paraqitjen e një Sinjalizimi pranë ILDKPKI.

KREU II HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 10

Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit

1. Njësia Përgjegjëse ose ILDKPKI shqyrton Sinjalizimin sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Gjatë hetimit administrativ, Njësia Përgjegjëse mund të kërkojë dokumente, të dhëna dhe shpjegime nga strukturat përkatëse të IdentiTek, të dëgjojë persona që kanë dijeni për çështjen dhe të administrojë çdo provë të nevojshme, duke garantuar në çdo rast konfidencialitetin e Sinjalizuesit.
2. Hetimi përfundon sa më shpejt, por jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga fillimi i tij.
3. Sinjalizuesi njoftohet për masat e marra brenda 30 (tridhjetë) ditëve dhe merr përgjigje brenda 30 (tridhjetë) ditëve për çdo kërkesë me shkrim mbi ecurinë e çështjes.
4. Vendimi për mos fillim ose përfundim dokumentohet në dosjen fizike dhe/ose elektronike, me arsyetim dhe masat përkatëse, dhe i njoftohet Sinjalizuesit në çdo rast, kur kjo është e mundur ose kur disponohen të dhëna kontakti.
5. Hetimi mund të mos fillojë kur Sinjalizimi nuk përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit, kur mungon informacioni minimal i nevojshëm edhe pas kërkesës për plotësim, ose kur nga verifikimi paraprak rezulton qartë se nuk ka elemente të një Shkeljeje.
6. Hetimi përfundon kur Sinjalizimi rezulton i bazuar, i pabazuar, ose kur konstatohet se është paraqitur me dashje informacion i rremë apo i pasaktë.

Neni 11

Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje

1. Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje nga Veprimet Hakmarrëse fillon me dorëzimin e kërkesës së Sinjalizuesit pranë ILDKPKI, i cili e regjistron dhe e shqyrton atë për të vlerësuar nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të besuar se një Veprim Hakmarrës ka ndodhur, është duke ndodhur ose pritet të ndodhë.
2. Brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës, ILDKPKI e regjistron atë dhe njofton me shkrim Sinjalizuesin. Kur ekziston rreziku i një Veprimi Hakmarrës, brenda 7 ditëve, ILDKPKI, vendos me një akt të ndërmjetëm të arsyetuar pezullimin e çdo veprimi hakmarrës ndaj Sinjalizuesit deri në përfundimin e hetimit. Sinjalizuesi njoftohet për statusin e shqyrtimit dhe çdo veprim procedural, si dhe mund të kërkojë informacion me shkrim në çdo kohë.
3. Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.

4. Ndalohet nisja e procedimeve penale, civile ose administrative ndaj personave të mbrojtur për shkak të Sinjalizimit të kryer në përputhje me ligjin.
5. Sinjalizuesi nuk mban përgjegjësi ligjore për raportimin ose publikimin e informacionit, kur ka pasur shkaqe të arsyeshme për të besuar se ato kanë qenë të nevojshme për zbulimin e një shkeljeje. Marrja ose aksesimi i informacionit nuk sjell përgjegjësi, përveç rasteve kur përbën vepër penale të veçantë.

Neni 12

Hyrja në fuqi dhe publikimi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit/nënshkrimit nga Administratori dhe publikohet në faqen zyrtare të IdentiTek.
2. Çdo punonjës i IdentiTek duhet të njihet me këtë rregullore, e cila komunikohet nëpërmjet emailit zyrtar ose çdo mjeti tjetër të brendshëm të komunikimit, dhe është i detyruar ta zbatojë atë.
3. Për çështje të cilat nuk parashikohet zgjidhje në këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Silda ANAGNOSTI ÇEPE

ADMINISTRATOR

